



# BULETIN JAVOR

## 11 - 15 MARS 2024

Shprehja

"Të argumentosh se nuk të intereson e drejta e privatësisë sepse nuk ke asgjë për të fshehur nuk është ndryshe nga të thuash se nuk të intereson liria e fjalës sepse nuk ke çfarë të thuash".

Edward Snowden

e javës

Përmbajtja:

- AKCESK në Takim me Autoritetet homologe të Kosovës: Bashkëpunim dhe Shkëmbim i Përvojës
- National Health Service (NHS) - Data Breach
- Microsoft - Patching Alert



### National Health Service (NHS) - Data Breach

Bordi i Shërbimit Shëndetësor Kombëtar (NHS) të Skocisë, në zonën e Dumfries dhe Galloway është shënjestruar nga hakerat, duke marrë të dhëna të ndjeshme nga pacientët. Organizata, e cila operon spitalet në Skoci, ka miratuar protokolle sigurie dhe po punon me policinë skoceze dhe Qendrën Kombëtare të Sigurisë Kibernetike të Mbretërisë së Bashkuar. Ofruesi i kujdesit shëndetësor po i kërkon stafit dhe publikut që të jenë vigjilentë për çdo përpjekje për të hyrë në sistemet ose qasjet e tyre nga kushdo që pretendon se zotëron të dhëna.

[Link: Lexo më shumë](#)

### PATCHING ALERT



### Microsoft - Patching Alert

Microsoft ka publikuar përditësime sigurie për 60 vulnerabilitete, 18 prej të cilave janë defekte të remote code execution (RCE). Përditësimet rregullojnë vetëm dy vulnerabilitete kritike: ekzekutimin e kodit në distancë Hyper-V dhe defektet e *denial of service*.

Disa vulnerabilitete interesante përfshijnë CVE-2024-21400, CVE-2024-26199, CVE-2024-20671 etj.

[Link: Lexo më shumë](#)



### AKCESK në Takim me Autoritetet homologe të Kosovës: Bashkëpunim dhe Shkëmbim i Përvojës

AKCESK pati këngësinë të mirëpresë ditën e sotme, më 13 Mars, kolegët nga Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP), Agjencia e Shoqërisë së Informacionit (ASHI) dhe KosCERT nga Kosova. Ky takim, i mbështur nga DCAF, u drejtua nga drejtori i përgjithshëm, Z.Igli Tafa në praninë e ekspertëve të AKCESK.

AKCESK prezantoi homologët nga Kosova me mënyrën e organizimit, funksionimit dhe përgjegjësi të Autoritetit, kuadrin ligjor, risitë dhe sfidat për sigurinë kibernetike në Shqipëri. Autoritetet vizituan gjithashtu ambientet e punës së qendrës operacionale kombëtare SOC.

Organizime të tilla i shërbejnë forcimit të bashkëpunimit ndërmjet autoriteteve respektive të vendeve të rajonit, shkëmbimit të eksperiencës dhe praktikave më të mira.